




PUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS
AGJENCIA SHITETËRORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS
DRŽAVNA AGENCIJA ARHIVA KOSOVA
THE STATE AGENCY OF KOSOVO ARCHIVES



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS
AGJENCIA SHITETËRORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS
DRŽAVNA AGENCIJA ARHIVA KOSOVA
STATE AGENCY OF KOSOVO ARCHIVES

Nr./No. 01/020/64/25
Data/Date: 03.03.2025

RAPORT VJETOR I PUNËS



2024

Prishtinë, 2025

RAPORT VJETOR I PUNËS

2024

PËRMBAJTJA

1	Fjala e Drejtorit Ekzekutiv	
	Fjala e Drejtorit Ekzekutiv	04
2	Përmbledhje Ekzekutive	07
	2.2 Struktura Organizative	07
3	Avancimi i Kornizes Ligjore	08
4	Rregullimi, Përpunimi dhe Përgatitja e dokumenteve për digjitalizim	08
	4.1 Rregullim, klasifikim dhe përgatitje për digjitalizim.....	09
	4.2 Mbrojta e materialit arkivor	10
5	Digjitalizimi i materialit arkivor	11
6	Shërbimi i qytetarëve me dokumente arkivore	12
	6.1 Hulumtimet Arkivore	13
7	Biblioteka e arkivit	14
8	Inspektimi dhe pranimi i lëndës arkivore të Fondkrijuesit	14
	8.1 Inspektimi i institucioneve fondkrijuese.....	14
	8.2 Pranimi i materialit arkivor.....	15
	8.3 Lista me afate të ruajtjes.....	16
9	Planifikim dhe zhvillim	17
10	Bashkëpunimi Ndërinstitucional dhe Ndërkombëtar	
	10.1 Takim në kuadër të bashkëpunimit mes ASHAK dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë.....	18
	10.2 Vizita zyrtare e Presidentit të Arkivave të Turqisë në ASHAK.....	19
	10.3 Vizita zyrtare në Republikën e Turqisë.....	20
	10.4 Pjesëmarrja në 75-vjetorin e themelimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë.....	20
	10.5 Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare.....	21
	10.6 Bashkëpunimi ndërinstitucional.....	22
11	Konferenca	23

PËRMBAJTJA

12	Promovime	
	12.1 Java e Arkivit të Hapur.....	24
	12.2 Promovimi i Revistes “Arkivat Shqiptare” dhe pjesëmarrja në Panairin e Tretë të Librit Akademik dhe Shkencor Mbarëkombëtar....	24
	12.3 Promovimi i Revistës “Arkivat Shqiptare” 1-2, 60-2024,.....	25
	12.4 Promovimi i librit “Programi dhe Statuti i Lëvisjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve.....	26
13	Ekspozita	
	13.1 Ekspozita për nder të 16-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.....	26
	13.2 Ekspozita “Rizgjimi në Vlera Kombëtare, Kosova Republikë”.....	27
	13.3 Ekspozita “Dorëshkrimet e Ismail Kadarese”.....	28
	13.4 Ekspozita “Të ndarë, por të pashkëputur”.....	29
14	Unifikimi i Procedurave të Punës.....	29
15	Trajnime	
	15.1 Trajnimet profesionale.....	30
	15.2 Trajnimet e avancuara.....	30
16	Investimet kapitale	
	16.1 Renovimi i objektit të ASHAK.....	31
	16.2 Hartimi i Projektit për ndërtimin e Arkivit Ndërkomunal në Gjilan..	32
	16.3 Funkcionalizimi i Kazermës së Vjetër në Prizren për Arkivin Ndërkomunal të Prizrenit.....	33
	16.4 Renovimi i Arkivit Ndërkomunal të Mitrovicës.....	34
	16.5 Renovimi i Depos në Arkivin Ndërkomunal të Pejës.....	35
	16.6 Funkcionalizimi i objektit të ri për Arkivin Ndërkomunal të Gjakovës.....	35
17	Buxheti dhe Financat.....	36
18	Burimet Njerëzore.....	37
19	Prokurimi.....	38



1. FJALA E DREJTORIT EKZEKUTIV

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (ASHAK), është institucion i vetëm ekzekutiv i administratës shtetërore që organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë arkivore në Republikën e Kosovës. Ky institucion funksionon në bazë të Ligjit Nr.08/L-111 për Arkivat, ndërsa organizimi funksional në kuptimin e parimeve të organizimit të administratës shtetërore, bazohet në standardet juridike të përcaktuara në Ligjin Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura. Për faktin se ky institucion përbrendëson përvojë të gjatë të funksionimit që nga perioda e ish – Jugosllavisë, respektivisht nga viti 1948, vlerësohet si institucion me një traditë tashmë të konsoliduar të mbledhjes dhe administrimit të lëndës arkivore në Republikën e Kosovës.

Në fillim të vitit 2024, kam vlerësuar se funksionimi i mirëfilltë i Agjencisë, më saktësisht përballimi me sukses i mandatit ligjor të saj, sfidohej kryesisht nga probleme që përshkojnë punën edhe të institucioneve të tjera të administratës shtetërore të Republikës së Kosovës dhe të niveleve tjera të organizimit të pushtetit. Që pas pranimit të mandatit tim në krye të Agjencisë, sfidat kryesisht përmbledheshin tek (i) mungesa e kapaciteteve administrative profesionale të përgatitura për të planifikuar, zbatuar e administruar një bazë të mirë logjistike, teknike e organizative të punës së Agjencisë, (ii) problemet me hapësirat adekuate dhe me kushte e standarde optimale për evidentimin, grumbullimin, ruajtjen, mbrojtjen, rregullimin dhe përpunimin e materialit arkivor që e posedon Agjencia, (iii) mungesën e hapësirave adekuate për pranimin e materialit arkivor që gjendet tek fondkrijuesit në moshë të dorëzueshme në Agjenci, (iiii) mungesa e organizimit të brendshëm të institucionit – funksionimi i deriatëhershëm nuk ishte në përputhje me Ligjin Nr.06/L – 113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura etj. Rekrutimet e munguara për një kohë të gjatë, mungesa e investimeve në furnizim me pajisje të teknologjisë që do të avancojnë më tej planin për digjitalizimin e materialit arkivor, investimet emergjente në ngritjen e nivelit të sigurisë së vendruajtjeve të materialeve, trajnimet e stafit, vlerësoheshin si mungesa që kërkonin ndërhyrje emergjente në periudhë afatshkurtër. Puna në drejtim të ngritjes së aftësive të përgjithshme operacionale dhe kapaciteteve profesionale, teknike dhe logjistike të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, në një këndvështrim më afatgjatë, ndikohej në mënyrë të drejtpërdrejt nga mbështetja që mund të ofrohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës dhe atë kryesisht përmes mbështetjes buxhetore në krijimin dhe funksionalizimin e njësive të brendshme organizative përgjegjëse për: planifikim dhe menaxhim financiar, administrativ, teknik dhe logjistik, fuqizimin dhe shtrirjen e njësive organizative të inspektimit që është obligim ligjor dhe njësive tjera të rregullimit dhe vendruajtjeve të materialit si dhe nëpërmjet investimeve në bazën infrastrukturore, teknike, teknologjike dhe operacionale.

Në mënyrë të veçantë, përkrahja e MKRS –së dhe e Qeverisë në aprovimin sa më të shpejt të organizimit të brendshëm të Agjencisë, ishte një hap i rëndësishëm në nisjen e procesit të gjithmbarshëm të konsolidimit të këtij institucioni kaq të rëndësishëm për memorien kolektive të shoqërisë sonë. Brenda vitit 2024, me angazhimin dhe përkrahjen e vazhdueshme të njëjseve ekzistuese të ASHAK, u arrit që të hartohet dhe miratohet Rregullorja Nr.16/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës si dhe u hartuan edhe 8 akte nënligjore që e përmbyllin të gjithë ciklin e legjislacionit dytësor të arkivave në Republikën e Kosovës, pas miratimit të Ligjit Nr.08/L – 111 për Arkivat. Në po këtë vit, hartua sipas procedurave standarde të aplikueshme edhe Strategjia Shtetërore e Arkivave të Kosovës me çka Kosova për herë të parë miraton një orientim strategjik zhvillimor shtatë (7) vjeçar për arkivat. Strategjia Shtetërore për Arkivat (SShA) në Kosovë 2025–2032, është dokumenti kryesor që përcakton objektivat, planet, veprimet e masat konkrete të institucioneve dhe palëve të tjera, në një kornizë strategjike për realizimin e këtyre objektivave, në drejtim të adresimit të sfidave dhe prioriteteve që mundësojnë ruajtjen, administrimin, prezantimin apo shfrytëzimin e materialit arkivor si shenjë e kujdesit, gjegjësisht respektit të shoqërisë e të shtetit, për kujtesën kolektive.

Strategjia Shtetërore për Arkivat (SShA) në Kosovë 2025 – 2032, e para e këtij lloji në Republikën e Kosovës, vjen si reagim i bartësve të përgjegjësive publike për formulimin dhe zbatimin e politikave publike në fushën e arkivave, përkatësisht vlerësimit aktual të kushteve e rrethanave të përgjithshme të ruajtjes së materialit arkivor në disa nivele në Kosovë, pra nga kushtet e ruajtjes së materialit që ndodhen arkivat kompetente duke përfshirë arkivat nën administrimin e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (ASHAK), arkivat e fondkrijuesve/fondposeduesve, arkivat speciale, arkivat private etj, si dhe duke identifikuar dhe vlerësuar problemet strukturore dhe objektive në formën e manifestimit të pasojave e shkaqeve të tyre, në mjedisin aktual të zhvillimit të veprimtarisë arkivore në Republikën e Kosovës me qëllim të përcaktimit të objektivave, masave e veprimeve të analizuara e koordinuara që mundësojnë realizimin e synimeve drejt zhvillimit të një sistemi të qëndrueshëm, modern, të sigurt dhe efikas të ruajtjes, mbrojtjes, përpunimit dhe rregullimit, administrimit dhe shfrytëzimit të materialit arkivor në përputhje me standardet ndërkombëtare të arkivistikës. Gjithnjë në bazë të vlerësimit të gjendjes aktuale, vizioni i Strategjisë është zhvillimi i një shërbimi arkivor kompetent, profesional dhe i aftë për të siguruar ruajtje të qëndrueshme të materialit arkivor në Republikën e Kosovës.

Në një periudhë të shkurtër u arrit që të plotësoheshin shumë nga pozicionet e munguara të punës profesionale, administrative dhe menaxhuese duke rritur ndjeshëm kapacitetet zbatuese të Agjencisë.

Ky ishte viti i fillimit të digjitalizimit masiv të materialit arkivor në të cilin ne digjitalizuar më shumë se 2.5 milionë dokumente ose vetëm në këtë vit, janë digjitalizuar 176% më shumë materiale se sa më shumë se 15 vite radhazi (1.08 milionë dokumente).

Buxheti i ndarë në vitin 2024 u shpenzuar në mbi 92% ndërsa rezultatet ishin të qarta.

Përfundoi renovimi i fazës së parë të ndërtesës së ASHAK, dhe u nënshkrua kontrata për hartimin e projektit për ndërtimin e Arkivit Ndërkomunal në Gjilan, një objekt modern me më shumë se 4,000 metra katror hapësirë e vendruajtjeve, muzeut arkivor, hapësirës për seminare, prezantime e takime, sallave të punës hulumtuese, laboratorike, të digjitalizimit, të rregullimit dhe përpunimit të materialit arkivor etj.

Në këtë vit, zgjeruam hapësirën për Arkivin Ndërkomunal të Gjakovës me marrjen në shfrytëzim afatgjatë të objektit me mbi 900 metra katror nga Keshilli Gjyqësor i Kosovës që do të krijoj zgjidhje për punë me kushte dhe standarde të pranuar në këtë njësi arkivore. Kjo hapësirë tashmë ndodhet në renovim e sipër.

Filloi renovimi i hapësirave ku do të vendoset Arkivi Ndërkomunal i Prizrenit, ndërsa filluam poashtu edhe renovimin e Arkivit Ndërkomunal të Pejës dhe të një aneksi të hapësirave të zgjeruara të Arkivit Ndërkomunal të Mitrovicës.

Në këtë vit, pranuar mbi 800 metra gjatësi lineare të materialit arkivor të njërive tona arkivore që mbaheshin ilegalisht nga strukturat paralele të financuara nga Serbia në komunat veriore.

Me pranimin e materialit arkivor nga Agjencia e Kosovës për Privatizim, praktikisht sasia e materialit arkivor që e posedon Agjencia Shtetërore e Arkivave, tashmë mund të thuhet se është dyfishuar.

Shërbimi ndaj qytetareve si një prej detyrave të rëndësishme që rrjedh nga Ligji Nr.08/L – 111 për Arkivat, tashmë është modernizuar duke funksionalizuar shërbimin përmes postes që ofron qasje të lehtë dhe të shpejta nga gjithë territori i Republikës së Kosovës në materialet arkivore përmes 145 zyrave postare ane e kënd Kosovës, përfshirë këtu edhe komunat veriore tashmë.

ASHAK përveç transformimit ligjor, të politikave dhe të infrastrukturës e të menaxhimit të materialit arkivor, me një dinamikë të kënaqshme po hapëron drejt transformimit digjital. Tashmë kemi nënshkruar kontratë për zhvillimin e Sistemit për Menaxhimin e Materialeve Arkivore i cili është në prag të funksionalizimit dhe që do të krijojë një platformë moderne të qasjes në arkiva për hulumtuesit, qytetarët e interesuar dhe për vet punën e arkivistëve brenda arkivave apo në terren.

Ky ishte vit i mobilizimit të plotë të kapaciteteve për transformimin e sistemit të menaxhimit të arkivave në Kosovë ndërkohë që mbetet e rëndësishme që punët në drejtim të arritjes së objektivave, të vijojnë edhe më tej për të parë sistemin tonë të organizimit të arkivave në hap me vendet e zhvilluara.

Në fund, nuk kam si të mos shpreh falënderimet e mia me të sinqerta për stafin menaxhues dhe profesional të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës për mbështetjen e pakursyer që kanë ofruar në arritjet vitit 2024. Agjencia u është mirënjohëse që të gjithë pa dallim, ofruan përkrahjen e tyre për një nga vitet më dinamike në punën e saj drejt arritjes së një misioni të rëndësishëm kritikë për kujtesën, historinë e faktografinë e shoqërisë, shtetit dhe të kombit.

Bislim Bislimi

Drejtor Ekzekutiv i ASHAK

2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE


Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (AShAK) është organ qeveritar që vepron në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duke ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-111 për Arkivat. Si institucioni përgjegjës për menaxhimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e sistemit arkivor në nivel shtetëror, mandati i saj buron nga legjislacioni në fuqi, duke e përcaktuar atë si garantuese të ruajtjes së trashëgimisë dokumentare të Republikës së Kosovës. AShAK është e përkushtuar të sigurojë ruajtjen e sigurt të materialeve arkivore, të ofrojë qasje për publikun dhe të promovojë rëndësinë e dokumenteve historike si pasuri kombëtare.

Vizioni i AShAK-ut përfshin përmirësimin e kushteve infrastrukturore, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e materialeve arkivore, mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për menaxhimin e dokumenteve dhe arkivave në të gjitha institucionet publike dhe private, si dhe krijimin e një arkivi digjital kombëtar që mundëson qasje të lehtë dhe të sigurt në dokumente historike dhe administrative. AShAK synon të ofrojë qasje cilësore në materialet arkivore për studiues, historianë dhe publikun e gjerë, duke krijuar platforma për shërbime digjitale që lehtësojnë kërkimet arkivore për nevoja profesionale, shkencore, publicistike dhe për nevoja të tjera të qytetarëve apo institucioneve vendore dhe më gjerë.

Raporti i punës për vitin 2024 pasqyron arritjet e Planit të Punës 2024, pavarësisht sfidave të shumta me të cilat u përballëm gjatë vitit, siç janë: kushtet jo adekuate infrastrukturore, mungesa e pajisjeve teknologjike, mungesa e burimeve njerëzore, etj. Gjatë vitit 2024, AShAK ka punuar në përputhje me Planin e Punës dhe vendimet e nxjerra nga Drejtori Ekzekutiv.

1.2 Struktura Organizative

Struktura organizative e AShAK përbëhet nga Drejtori Ekzekutiv, Zëvendës Drejtori Ekzekutiv, shtatë (7) departamente, dhe njëzet e gjashtë (26) divizione.



Struktura organizative e AShAK

3. AVANCIMI I KORNIZËS LIGJORE

Grupi punues për hartimin e Strategjisë për Arkiva Shtetërore, përmes punëtorive dhe shkëmbimeve elektronike gjatë vitit 2024, ka përgatitur draftin e strategjisë dhe e ka dorëzuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) brenda afatit të përcaktuar. Aktualisht, dokumenti është në fazën e konsultimit publik.

Në bazë të Ligjit Nr. 08/L-111 për Arkivat dhe detyrimeve që burojnë prej tij, gjatë vitit 2024, janë miratuar pesë (5) rregullore të rëndësishme, të cilat janë si më poshtë:

1. Rregullorja (ZKM) Nr. 16/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ASHAK;
2. Rregullorja (MKRS) Nr. 02/2024 për Dorëzimin dhe Pranimin e Materialit Arkivor;
3. Rregullorja (MKRS) Nr. 03/2024 për Standardet Teknike, Kriteret, Rregullat dhe Përgjegjësitë për Kujdesin, Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Materialit Arkivor, si dhe Procedurat për Asgjësimin e tij;
4. Rregullorja (MKRS) Nr. 06/2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Shfrytëzimit të Materialit Arkivor;
5. Rregullorja (MKRS) Nr. 07/2024 për Kushtet, Kriteret dhe Normat e Detyrueshme për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Përdorimin e Materialit Arkivor.

Përveç rregulloreve të miratuara, janë hartuar dhe dorëzuar në MKRS për procedim të mëtejme këto projekt-rregullore:

1. Draft Rregullorja (MKRS) XX/2024 për Programin, Përmbajtjen, Mënyrën dhe Procedurat e Organizimit të Trajnimit Profesional për Zyrtarët Arkivorë;
2. Draft Rregullorja për Procedurat e Miratimit të Pëlqimit të ASHAK për Themelimin e Arkivave Private;
3. Draft Rregullorja (MKRS) Nr. XX/2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Nxjerrjes së Materialit Arkivor Jashtë Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

Këto iniciativa dhe akte rregullative përfaqësojnë angazhimin e ASHAK për të përmbushur detyrimet ligjore dhe për të avancuar standardet në ruajtjen, menaxhimin dhe promovimin e materialit arkivor në Kosovë.

4. RREGULLIMI, KLASIFIKIMI DHE PËRGATITJA E DOKUMENTEVE PËR DIGJITALIZIM

ASHAK administron dhe ruan rreth 9 kilometra gjatësi lineare të materialit arkivor, duke siguruar menaxhimin dhe mbrojtjen e kujtesës institucionale dhe historike të vendit.


Veprimtaria e ASHAK përfshin rregullimin, përpunimin, konservimin dhe digjitalizimin e këtyre materialeve, duke u bazuar në standardet më të larta profesionale dhe teknike. Këto procese synojnë garantimin e ruajtjes afatgjatë dhe lehtësimin e qasjes për studiuesit dhe publikun.

Përgatitja e materialeve arkivore për digjitalizim ka qenë një ndër prioritetet kryesore të AShAK gjatë vitit 2024, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë dhe efikasitetin e këtij procesi. Kjo fazë përfshin sistemimin, përpunimin dhe krijimin e kushteve optimale për digjitalizimin e dokumentacionit. Më poshtë paraqitet Raporti i Punës për vitin 2024, i strukturuar sipas njësive organizative të AShAK-së.

4.1 Rregullim, klasifikim dhe përgatitje për digjitalizim

Departamenti i Veprimtarisë Arkivore - Divizioni i Rregullimit dhe Përpunimit ka rregulluar dhe përgatitë për digjitalizim **2,516, 271¹** faqe, përkatësisht 3306 kuti apo 396.64m.gj nga fondet:

- Gjykata e Qarkut Prishtinë, njësia organizative penale, vitet 1945/1962;
- Kryesia e Krahinës Socialiste Autonome e Kosovës, vitet 1954 - 1990;
- Gjykata Ekonomike e Kosovës - Njes.Org: Dega në Gjakovë (shkronjat F, H, I, J, K, G, dhe GJ);



Arkivi Ndërkomunal Prishtinë - ka rregulluar dhe përpunuar 16.73 m. gj., ka klasifikuar 9.07 m.gj. dhe ka ndarë për asgjësim 5.19 m/gj., e materialit arkivore, në fondin:

- Gjykata Komunale Prishtinë, vërtetime, kontrata– vitet 1979 dhe1995-1998.

¹Në përputhje me Vendimin nr. 54/2024 të datës 27/06/2024 të Drejtorit Ekzekutiv, përgatitja e materialit arkivor është realizuar me angazhimin e stafit shtesë nga departamente tjera.

Arkivi Ndërkomunal Gjakovë – ka regjistruar 6387 emra në exel nga librat amë nr.1,2,3,4,5, vitet 1962 -63 deri 1982/ 83; nr.6,7,8,9,10, vitet 1972/1973 dhe nr.1,2,3, vitet 1962 -63, 1972 – 1973 dhe 1967 – 1979, të fondit SHFMU Zekrija Rexha.

Janë rregulluar 8.50 m.gj të materialit arkivor nga Fondet me numër të inventarit: 4, 5, 6, 8, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19².

Arkivi Ndërkomunal Mitrovicë - ka rregulluar dhe përpunuar 6.5m.gj., ka klasifikuar 43.6 dhe ka ndarë për asgjësim 12.5 m.gj të materialit arkivor në fondet:

- Kuvendi Komunal-Mitrovicë, vitet 1930/1980;
- Këshilli Popullor i Rrethit, vitet 1942/1959.

Arkivi Ndërkomunal Prizren - ka rregulluar dhe përpunuar **32.19** m. gj., ka klasifikuar **60.55** m.gj., ka regjistruar 8109 emra dhe ka ndarë për asgjësim 42,68 m.gj. të materialit arkivor në këto fonde:

- Gjimnazi Jovanka Radivojeviç-Kica, vitet 1980 /1998;
- Gjimnazi Ruzhdi Berisha – Dragash, vitet 1969 /1990;
- Gjimnazi Jeta e Re – Suharekë, vitet 1969 /1999;
- Ministria e Punëve të Brendshme/ Stacioni Policor - Lubizhdë, vitet 1990 – 1998;
- Akademia Pedagogjike “Dimitrie Tucoviç”, vitet 1946 – 1963.

Arkivi Ndërkomunal Gjilan - ka rregulluar dhe përpunuar 39.75 m.gj., ka klasifikuar 8.5 m.gj. dhe ka ndarë për asgjësim 8.71m.gj. të materialit arkivor në fondet:

- Kuvendi Komunal, vitet 1946/2002;
- Shkolla Normale - Skenderbeu, vitet 1969/1976;
- Shkolla Filllore – Skenderbeu, Hogosht, vitet 1949/ 1998

Arkivi Ndërkomunal Pejë - ka rregulluar dhe përpunuar 17.57m. gj., ka klasifikuar 24.38m.gj. dhe ka ndarë për asgjësim 6,76 m.gj. të materialit arkivor në fondet:

- Gjykata e Rrethit Pejë (të ndryshme), vitet 1945-1965; dhe
- Gjykata e QarkutPejë (civile), vitet 1981 - 1991.

Arkivi Ndërkomunal Ferizaj – ka rregulluar dhe përpunuar 12.7 m.gj të materialit arkivor në fondin:
·Gjykata e Qarkut Ferizaj, vitet 1951 / 1963.

4.2 Mbrojtja e materialit arkivor

Përveç rregullimit dhe përgatitjes së materialeve arkivore, AShAK ka realizuar konservimin e 1,238³ faqeve në format A4, prej të cilave 1,000 faqe janë restauruar me dorë, duke aplikuar teknika të avancuara dhe profesionale të ruajtjes. Ky proces synon mbrojtjen afatgjatë të dokumentacionit arkivor dhe sigurimin e integritetit të tij për brezat e ardhshëm.

² Për arsye se fondet kanë sasi të vogël të materialit, janë vendos në raport vetëm me numër të fondit. Raporti edhe me emër të fondeve është në Raportin e ANK - Gjakovë


³ Në bazë të Vendimit nr. 54/2024, datë 27.06.2024, të Drejtorit Ekzekutiv, zyrtarët e këtij divizioni kanë qenë të angazhuar në përgatitjen e materialeve për digjitalizim.

5. DIGJITALIZIMI I MATERIALIT ARKIVOR

Në përputhje me objektivat e punës, prioriteti kryesor i AShAK-së për vitin 2024 ishte fillimi i procesit të digjitalizimit masiv të materialeve arkivore, si pjesë e përkushtimit për ruajtjen afatgjatë dhe modernizimin e qasjes në dokumentacionin arkivor. Ky proces synon jo vetëm ruajtjen fizike të materialeve, por edhe rritjen e qasjes dhe efikasitetit në menaxhimin e tyre. Procesi i digjitalizimit përfshin një gamë të gjerë aktivitetesh, duke filluar nga përgatitja dhe klasifikimi i materialeve deri te skanimi, indeksimi dhe ruajtja e tyre në formate elektronike sipas standardeve më të larta ndërkombëtare. Kjo iniciativë strategjike është një hap i rëndësishëm drejt digjitalizimit të plotë të fondit arkivor të Kosovës, duke siguruar ruajtjen e trashëgimisë dokumentare dhe mundësimin e qasjes së lehtë për studiuesit, institucionet dhe publikun e gjerë.

Si rezultat i këtij procesi, gjatë vitit 2024 janë digjitalizuar gjithsej **2,516, 271** faqe dokumentesh arkivore, nga fondet:

- Gjykata e Qarkut Prishtinë;
- Kryesia e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës;
- Gjykata Ekonomike – Dega në Gjakovë;



Gjatë procesit të digjitalizimit të materialit arkivor

Krahas procesit të digjitalizimit masiv të realizuar në bashkëpunim me Operatorin Ekonomik, Arkivat Ndërkomunale, përkatësisht ANK-Gjakovë dhe ANK-Prizren, kanë vijuar me sukses digjitalizimin e **45,892** faqeve të dokumenteve arkivore nga fondet e tyre përkatëse.

Procesi i digjitalizimit është realizuar nga dy zyrtarë të Arkivave Ndërkomunale, të cilët kanë përbushur këtë detyrë me përkushtim të lartë dhe në përputhje me standardet më të mira arkivore.

Fondet e digjitalizuara në ANK janë si në vijim:

- Kuvendi Komunal Gjakovë;
- Gjykata e Rrethit Prizren;
- Mbretëria Shqiptare;
- Komasacioni dhe
- Këshilli Popullor i Rrethit.

Përveç procesit të digjitalizimit të materialeve arkivore, janë realizuar me sukses edhe aktivitetet e mëposhtme:

- Indeksimi elektronik i 1,588 mikrokuadrove të mikrofilmave nga fondet Sig VIII-SHBA\1211-12 dhe Sig VIII-SHBA\1211-13, duke i përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe;
- Indeksimi i dokumenteve osmane nga Defteri TTD – TT, që përfshin 75 faqe;
- Mirëmbajtja dhe kontrolli periodik i 1,200 mikrokuadrove të mikrofilmave nga fondet Sig V/1-2, Sig IV/1-3 dhe Sig/1-4.

6. SHËRBIMI I QYTETARËVE ME DOKUMENTE ARKIVORE

Në vitin 2024, AShAK ka zbatuar një sistem të ri për ofrimin e shërbimeve arkivore, duke e bërë më të thjeshtë dhe më efikas qasjen e qytetarëve në dokumentacionin arkivor. Ky sistem mundëson pranimin e aplikacioneve dhe shpërndarjen e dokumenteve arkivore në të gjitha pikat postare të Postës së Kosovës, duke reduktuar ndjeshëm kohën e pritjes dhe nevojën për udhëtime të gjata.

Pas përpunimit nga AShAK, dokumentet arkivore dorëzohen përmes Postës së Kosovës, duke siguruar shpërndarje të shpejtë dhe të sigurt te qytetarët në adresat e tyre.

Posta e Kosovës, duke shfrytëzuar rrjetin e saj të gjerë të shërbimeve, mundëson pranimin e aplikacioneve nga qytetarët në çdo pikë postare. Ky sistem i ri synon rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e përvojës së qytetarëve në marrjen e shërbimeve arkivore, duke siguruar një proces të standardizuar dhe të besueshëm. Përmes këtij modeli të avancuar, garantojnë cilësinë, integritetin dhe sigurinë e dokumenteve arkivore.

Gjatë vitit 2024, janë pranuar dhe trajtuar gjithsej **2,324** kërkesa për dokumente arkivore dhe hulumtime të materialit arkivor nga qytetarët dhe institucionet.

Kërkesat janë trajtuar në përputhje me standardet profesionale dhe procedurat e përcaktuara, duke siguruar qasje transparente dhe efektive.

Falë bashkëpunimit me Postën e Kosovës, dorëzimi i dokumenteve për shumicën e këtyre kërkesave është realizuar me sukses brenda një periudhe të shkurtër, duke reduktuar ndjeshëm kohën e pritjes.

Ky angazhim dhe eficienca e treguar gjatë trajtimit të këtyre kërkesave dëshmojnë përkushtimin për të përmbushur nevojat e qytetarëve dhe institucioneve me profesionalizëm dhe në përputhje me standardet më të larta të menaxhimit arkivor.

Në vijim paraqiten të dhënat për shërbimin e qytetarëve, sipas njësive të AShAK-së:

Departamenti për Veprimtari Arkivore	Arkivi Ndërkomunal Prishtinë	Arkivi Ndërkomunal Gjakovë	Arkivi Ndërkomunal Mitrovicë
439 Kërkesa	523 Kërkesa	146 Kërkesa	447 Kërkesa
Arkivi Ndërkomunal Prizren	Arkivi Ndërkomunal Gjilan	Arkivi Ndërkomunal Pejë	Arkivi Ndërkomunal Ferizaj
285 Kërkesa	238 Kërkesa	244 Kërkesa	2 Kërkesa

Gjatë vitit 2024, AShAK ka trajtuar me sukses edhe kërkesat për qasje në dokumente zyrtare nga qytetarë, gazetarë dhe palë të tjera të interesuara, duke siguruar një shërbim transparent dhe profesional. Këto kërkesa janë përpunuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me një përkushtim të veçantë për respektimin e të drejtës së informimit.

AShAK mbetet e angazhuar në ofrimin e qasjes në dokumente arkivore dhe zyrtare, duke respektuar kuadrin ligjor në fuqi.

6.1 Hulumtimet arkivore

Në Sallën e Hulumtimeve, gjatë vitit 2024 janë ofruar për përdorim **676** kuti arkivore për hulumtuesit që kanë frekuentuar sallën. Ky shërbim ka qenë pjesë e përkushtimit për të ofruar qasje të plotë dhe efikase në fondet arkivore për studiues dhe individë të interesuar.

Përveç shërbimeve të drejtpërdrejta për hulumtuesit, *Divizioni për Menaxhimin e Vendruajtjes së Materialeve Arkivore* ka realizuar edhe furnizimin e rregullt me materiale arkivore për të mbështetur punën operative të *Divizionit të Rregullimit dhe Përpunimit*, *Divizionit të Mbrojtjes së Lëndës Arkivore dhe Njësisë së Digjitalizimit*. Kjo qasje e koordinuar ka siguruar vijueshmërinë dhe efikasitetin në përmbushjen e objektivave institucionale.



Salla e hulumtimit në AShAK

7. BIBLIOTEKA E ARKIVIT

Përveç ruajtjes dhe menaxhimit të dokumenteve arkivore, AShAK administron edhe Bibliotekën e Arkivit, e cila përmban rreth 13,000 titujsh bibliotekar, ndër të cilët disa përfaqësojnë vlera të veçanta dhe të rralla.

Për të siguruar mirëmbajtjen, menaxhimin dhe shfrytëzimin efikas të fondit bibliotekar, gjatë vitit janë skanuar 540 koopertina librash, të cilat janë regjistruar dhe kataloguar në sistemin e skedimit digjital. Ky proces synon të lehtësojë qasjen për studiuesit dhe përdoruesit e tjerë, duke ruajtur njëkohësisht integritetin dhe cilësinë e materialeve bibliotekare. Mirëpo, me fillimin e procesit të renovimit të hapësirave të AShAK, të gjitha librat e bibliotekës janë zhvendosur përkohësisht në depot e institucionit. Si pasojë e kësaj zhvendosjeje, proceset e skanimit dhe katalogimit të librave janë pezulluar përkohësisht, deri në përfundimin e risistemimit të botimeve dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për vijimin e këtyre aktiviteteve.



Biblioteka e AShAK pas renovimit dhe sistemimit të botimeve

8. INSPEKTIMI DHE PRANIMI I MATERIALIT ARKIVOR TE FONDKRIJUESIT

8.1. Inspektimi i institucioneve fondkrijuese

Gjatë vitit 2024, inspektimet arkivore në institucionet qendrore dhe lokale kanë qenë thelbësore për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e menaxhimit të dokumenteve dhe arkivave, duke siguruar përputhjen me legjislacionin në fuqi.

Në kuadër të këtyre inspektimeve, janë realizuar gjithsej **202 vizita**⁴ të institucione të ndryshme, duke përfshirë ministri, agjenci shtetërore, komuna dhe njësi tjera administrative. Objektivi kryesor i këtyre inspektimeve ka qenë të vlerësohet gjendja aktuale e arkivave, të identifikohen mangësitë dhe të ofrohen rekomandime për përmirësimin e menaxhimit arkivor.

⁴Detajet e institucioneve të vizituara janë të paraqitura në raportet periodike të AShAK.

Në vijim paraqesim të dhënat për inspektimet, sipas njësive të AShAK-së:

Departamenti i Inspektimit	Arkivi Ndërkomunal Prishtinë	Arkivi Ndërkomunal Gjakovë	Arkivi Ndërkomunal Mitrovicë
44 vizita	/	48 vizita	17 vizita
Arkivi Ndërkomunal Prizren	Arkivi Ndërkomunal Gjilan	Arkivi Ndërkomunal Pejë	Arkivi Ndërkomunal Ferizaj
8 vizita	61 vizita	2 vizita	22 vizita

8.2. Pranimi i materialit arkivor

Në kuadër të përmbushjes së mandatit ligjor për administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit me vlerë të përhershme, AShAK ka realizuar pranimin dhe integrimin e një sasive të konsiderueshme materiale arkivore nga institucionet fondkrijuese.

Një sasi rreth 820 metra gjatësi lineare të dokumentacionit arkivor, i cili mbahej ilegalisht nga strukturat paralele në komunat veriore të Kosovës, është transferuar dhe sistemuar në AShAK. Ky proces, i realizuar në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, përfaqëson një hap të rëndësishëm në konsolidimin dhe administrimin e duhur të arkivave shtetërore, duke siguruar ruajtjen dhe trajtimin profesional të këtij dokumentacioni sipas standardeve ligjore.

Dokumentacioni i pranuar përfshin materiale me rëndësi administrative, juridike dhe historike, duke pasqyruar zhvillimet e ndryshme nga periudha 1943–2000. Megjithëse një pjesë e këtyre dokumenteve është prodhuar nga struktura ilegale, ato mund të shërbejnë si burime të vlefshme për hulumtime dhe analiza historike.

Pranimi i dokumentacionit arkivor nga strukturat paralele në Mitrovicën e Veriut përbën një zhvillim të rëndësishëm në procesin e konsolidimit të arkivave shtetërore. Ky hap jo vetëm që siguron ruajtjen dhe administrimin e materialeve arkivore në përputhje me standardet profesionale, por gjithashtu ndikon në përforcimin e transparencës institucionale dhe në garantimin e një qasjeje të strukturuar ndaj trashëgimisë dokumentare të vendit.



Gjendja e materialit arkivor në Leposaviq

Përveç dokumentacionit të pranuar nga Mitrovica e Veriut, AShAK ka realizuar edhe pranimin e 97 metrave gjatësi lineare të materialit arkivor nga institucionet tjera fondkrijuese dhe nga persona fizik. Ky dokumentacion është dorëzuar në përputhje me afatet ligjore për transferimin e dokumenteve me vlerë të përhershme në arkiv, duke reflektuar përkushtimin institucional për ruajtjen dhe administrimin e duhur të trashëgimisë dokumentare.

Pranimi i këtyre fondeve arkivore⁵, përfshirë 820 metra gjatësi lineare nga Mitrovica e Veriut dhe 97 metra gjatësi lineare nga institucionet e tjera fondkrijuese, përfaqëson një hap të rëndësishëm në forcimin dhe pasurimin e sistemit arkivor shtetëror.

8.3 Lista me afate të ruajtjes

ASHAK, si institucion kompetent për administrimin e dokumentacionit arkivor, gjatë vitit 2024 ka realizuar pranimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e Listave me Afate të Ruajtjes të dorëzuara për marrje të pëlqimit nga institucionet fondkrijuese. Ky proces është zhvilluar në përputhje me Rregulloren (MAP) Nr. 01/2015 për Shenjat Unike të Klasifikimit të Dokumenteve dhe Afatet e Ruajtjes së tyre.

Gjatë shqyrtimit, për disa fondkrijues është kërkuar plotësimi dhe korigjimi i listave, duke siguruar përputhjen me standardet arkivore.

Pëlqimi për miratim të listave u dha për institucionet e mëposhtme:

1. Komunën e Kaçanikut;
2. Komunën e Obiliqit;
3. Komunën e Mitrovicës së Jugut;
4. Komunën e Mitrovicës së Veriut;
5. Inspektoratin e Punës;
6. Agjencinë Kadastrale e Kosovës;
7. Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar;
8. Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale.

⁵Detajet e fondeve të pranuar janë të paraqitura në raportet periodike të AShAK.

Për institucionet në vijim, listat e dorëzuara për marrje të pëlqimit nuk kanë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore, ndaj dhe janë kërkuar përmirësime shtesë:

1. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) – Lista është shqyrtuar dy herë, janë dhënë rekomandime për përmirësim, por nuk është dhënë Pëlqimi për shkak të mangësive;
2. Agjencia Kosovare e Komisionit të Verifikimit të Pronës (AKKVP) – Dokumentacioni është dorëzuar në tre drafte, është shqyrtuar dhe janë dhënë propozime për ndryshime, por Pëlqimi nuk është dhënë, pasi ende nuk janë përmbushur të gjitha kriteret ligjore.

9.PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe avancimit të politikave zhvillimore, AShAK ka hartuar dhe miratuar një sërë dokumentesh, plane veprimi dhe raporte, të cilat sigurojnë transparencë, efikasitet dhe zhvillim të qëndrueshëm institucional.

Për të garantuar një menaxhim të strukturuar dhe të përputhur me objektivat institucionale, janë hartuar dokumentet e mëposhtme:

- Plani Vjetor i Punës 2024;
- Plani Kombëtar për Zhvillim 2025-2027;
- Plani i Performancës 2025;
- Plani i Integritetit 2024-2026.

Për të vlerësuar progresin dhe për të siguruar implementimin efektiv të objektivave të përcaktuara, janë përgatitur:

- Raportet periodike dhe raporti vjetor;
 - Analiza e raporteve periodike dhe vjetore;
 - Raporti i arritjeve të AShAK gjatë mandatit të Qeverisë Kurti II (mars 2021 – mars 2024) – pasqyrë e detajuar e progresit dhe iniciativave të ndërmarra;
 - Raporti mbi zbatimin e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë – vlerësim i shkëmbimit të përvojave dhe projekteve të përbashkëta;
 - Raporti mbi zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Yad Vashem, Izrael;
 - Raporti vjetor për qasje në dokumente zyrtare;
 - Raporti gjashtëmujor dhe vjetor mbi planin e integritetit – monitorim i zbatimit të masave për transparencë dhe qeverisje të mirë.
-
- Përmes këtyre planeve dhe raporteve është synuar forcimi i kapaciteteve institucionale, përmirësimi i menaxhimit të burimeve arkivore dhe garantimi i qasjes së lehtë dhe të sigurt në dokumentacionin arkivor.

10. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR

10.1 Takim në kuadër të bashkëpunimit mes AShAK dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë

Në vijim të zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë (DPA), më 08.02.2024, Drejtori Ekzekutiv i AShAK-së, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, realizoj vizitë zyrtare në ambientet e DPA-së.

Takimi u fokusua në forcimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve arkivore më të rëndësishme të hapësirës shqiptare. U diskutua mbi historikun e deritanishëm të partneritetit, si dhe mbi hapat e ardhshëm për rritjen e kapaciteteve institucionale. Vëmendje e veçantë iu kushtua transformimeve organizative dhe investimeve strategjike, të cilat janë në fazë planifikimi, realizimi apo përfundimi, me synimin për të krijuar një shërbim arkivor të unifikuar në nivel kombëtar.

Po ashtu, në takim u theksua rëndësia e transpozimit të modeleve të suksesshme të punës profesionale, si dhe e forcimit të infrastrukturës teknike dhe teknologjike për garantimin e ruajtjes afatgjatë dhe me standarde të larta të trashëgimisë dokumentare, intelektuale, historike dhe kulturore.

Pas takimit, përfaqësuesit e dy institucioneve vizituan ambientet e modernizuara të DPA-së, duke përfshirë: njësinë e trajnimeve dhe inspektimit, qendrën e digjitalizimit të materialeve arkivore, sallat e hulumtimit dhe administrimit të shërbimit online, laboratorin e konservimit dhe restaurimit të lëndës arkivore, punishten e muzeut arkivor që po ndërtohet pranë ndërtesës qendrore, hapësirën e amfiteatrit në oborrin e DPA-së, si dhe vendruajtjet e reja dhe të rinovuara të materialeve arkivore në Shkozë, Tiranë.

Ky takim riafirmoi angazhimin e përbashkët të dy institucioneve për ruajtjen, digjitalizimin dhe promovimin e trashëgimisë arkivore kombëtare, duke krijuar një bazë më të fortë për zhvillime të mëtejshme në këtë fushë.



Qaste nga takimi i delegacionit të AShAK në DPA Shqipëri

10.2 Vizita zyrtare e Presidentit të Arkivave të Turqisë në AShAK

Në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit mes Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dhe Drejtorisë së Arkivave Shtetërore të Turqisë, me mbështetjen e Ambasadës së Republikës së Turqisë në Kosovë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më 20-22 shkurt 2024, AShAK priti në një vizitë zyrtare z. Uğur Ünal, Presidentin e Arkivave të Turqisë, i cili u prit nga Drejtori Ekzekutiv i AShAK-së, z. Bislam Bislimi, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij.

Qëllimi kryesor i vizitës ishte forcimi dhe thellimi i bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve arkivore. Gjatë takimit u rivlerësuan marrëdhëniet e shkëlqyera të deritanishme dhe u diskutua nevoja për konkretizimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh në disa fusha kyçe, duke përfshirë:

- Hulumentimin arkivor të studiuesve, studentëve dhe qytetarëve në arkivat e të dy vendeve;
- Digjitalizimin e materialeve arkivore për të lehtësuar qasjen dhe ruajtjen e tyre;
- Trajnimin e specialistëve në fushën e restaurimit - konservimit dhe digjitalizimit të dokumenteve;
- Zbatimin e standardeve bashkëkohore për zhvillimin dhe projektimin e infrastrukturës fizike të hapësirave arkivore.

Në kuadër të vizitës, dy udhëheqësit e institucioneve arkivore më të larta të Kosovës dhe Turqisë mbajtën një konferencë të përbashkët për media, ku shpalosën vizionin e përbashkët për thellimin e bashkëpunimit në fushën e arkivistikës. Gjithashtu, ata u pritën në një takim zyrtar nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, ku u konfirmua niveli i lartë i bashkëpunimit reciprok ndërmjet dy institucioneve.

Në ditën e dytë të vizitës, delegacioni i kryesuar nga Drejtori Ekzekutiv i AShAK-së, z. Bislam Bislimi, dhe Presidenti i Arkivave të Turqisë, z. Uğur Ünal, vizituan Arkivit Ndërkomunal të Prizrenit ku u pritën nga Drejtori dhe zyrtarët e tjerë të ANK-Prizren. Më pas, delegacioni zhvilloi një takim me Konsullin e Përgjithshëm të Turqisë në Prizren, z. Celal Dogan.

Kjo vizitë riafirmoi angazhimin e përbashkët për forcimin e lidhjeve institucionale dhe zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në fushën e arkivave, duke krijuar një platformë të re për shkëmbimin e përvojave dhe njohurive mes dy vendeve.



Qaste nga pritja e Presidentit të Arkivave të Turqisë

10.3 Vizita zyrtare në Republikën e Turqisë

Më 18-19 prill 2024, një delegacion i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, me pjesëmarrjen e Drejtorit Ekzekutiv, z. Bislim Bislimi, dhe nën kryesimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, u realizua vizitë zyrtare në Republikën e Turqisë, me ftesë të Presidencës së Arkivave Shtetërore të Turqisë.

Takimet nisën me një vizitë në Kryesinë e Pallateve Kombëtare, ku delegacioni u prit nga kryetari i institucionit, Dr. Yasin Yıldız. Gjatë takimit u diskutuan në mënyrë të detajuar format e bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke në të ardhmen, me fokus në shkëmbimin e përvojave për administrimin dhe menaxhimin e hapësirave kulturore, turizmit, muzeve dhe trashëgimisë kulturore. U theksua rëndësia e shfrytëzimit të këtyre potencialeve për të nxitur mirëqenien ekonomike dhe për të forcuar kohezionin social.

Në ditën e dytë të vizitës, delegacioni zhvilloi një takim në ambientet e Arkivit Osman në Stamboll, ku u prit nga Presidenti i Arkivave Shtetërore të Presidencës së Republikës së Turqisë, Prof. Dr. Uğur Ünal, dhe ekipi i tij. Ministri Çeku dhe Drejtori Ekzekutiv Bislimi shprehën mirënjohjen për mikpritjen dhe gatishmërinë e palës turke për të ndërtuar një bashkëpunim të qëndrueshëm dhe të frytshëm në fushën e arkivave. Ky partneritet synon të forcojë qasjen ndaj dokumentacionit me vlerë arkivore në të dy vendet dhe të sigurojë rezultate konkrete në zhvillimin e kapaciteteve arkivore dhe kërkimore.



Gjatë vizitës zyrtare në Republikën e Turqisë

10.4 Pjesëmarrja në 75-vjetorin e themelimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë

Më 5-8 qershor 2024, një delegacion i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, i kryesuar nga Drejtori Ekzekutiv z. Bislim Bislimi, mori pjesë në aktivitetet e shënimit të 75-vjetorit të themelimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë.

Kjo ngjarje e rëndësishme për historinë e arkivave shqiptare mbledhi përfaqësues nga 16 vende të rajonit dhe botës, përfshirë Izraelin, Italinë, Turqinë, Ukrainën, Kroacinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Egjiptin, Rumaninë, Moldavinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Hungarinë, Bullgarinë, etj. Pjesëmarrja e gjerë dëshmoi rëndësinë ndërkombëtare të këtij jubileu dhe mundësinë për forcimin e bashkëpunimeve arkivore ndërkombëtare.

Delegacioni i Kosovës pati mundësinë të shkëmbejë përvoja dhe kontakte me përfaqësues të institucioneve homologe nga vende të ndryshme, duke theksuar rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit në projekte të përbashkëta arkivore. Këto angazhime synojnë jo vetëm ruajtjen dhe digjitalizimin e dokumentacionit historik, por edhe lehtësimin e qasjes për studiuesit dhe publikun e gjerë.

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i AShAK-së në këto aktivitete të nivelit të lartë riafirmojnë përkushtimin e institucionit në forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, modernizimin e arkivave dhe promovimin e trashëgimisë dokumentare të Kosovës në arenën globale.



Gjatë pjesëmarrjes në 75 vjetorin e themelimit të DPA - Shqipëri

10.5 Pjesëmarrja në takime Ndërkombëtare

- Me qëllim të anëtarësimit të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës në Portalin e Arkivave Evropiane, më 9 korrik 2024, përfaqësues të AShAK zhvilluan një takim me Drejtorin e Bordit të Portalit të Arkivave Evropiane, z. Zoltán Szatucsek, i cili njëkohësisht ushtron edhe detyrën e Drejtorit të Arkivit Kombëtar të Hungarisë. Gjatë takimit u diskutua rëndësia e integritimit të AShAK-së në këtë platformë prestigjioze, e cila ofron mundësinë e vendosjes së të dhënave arkivore në sistemin digjital dhe lehtëson qasjen e studiuesve dhe publikut në trashëgiminë dokumentare të Evropës përmes kërkimit online. Anëtarësimi në këtë portal do të përfaqësojë një hap të rëndësishëm për ndërkombëtarizimin e arkivave të Kosovës, duke rritur qasjen në burimet arkivore të vendit në nivel evropian.

- Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, si anëtare e kategorisë A në Këshillin Ndërkombëtar të Arkivave (ICA), mori pjesë aktive në Asamblenë e Përgjithshme të ICA-së. Ky forum i rëndësishëm ndërkombëtar shërbeu si platformë për informimin e anëtarëve mbi aktivitetet dhe projektet kryesore të ICA-së, si dhe për shqyrtimin dhe miratimin e raporteve financiare të organizatës. Në kuadër të asamblesë, u zhvillua gjithashtu procesi i votimit mbi çështje strategjike dhe organizative, ku AShAK kontribuoi drejtpërdrejt, duke forcuar angazhimin e saj në vendimmarrjen globale për arkivat dhe trashëgiminë dokumentare. Pjesëmarrja aktive e AShAK-së në këtë event konfirmon përkushtimin e institucionit për të ndërtuar dhe forcuar partneritete ndërkombëtare në fushën e arkivistikës.

10.6 Bashkëpunimi Ndërinstitucional

- Në kuadër të marrëveshjeve ndërinstitucionale, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës dhe Posta e Kosovës nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi, e cila përcakton procedurat standarde operative për pranimin e aplikacioneve dhe dorëzimin e dokumenteve arkivore. Kjo marrëveshje synon të lehtësojë dhe përmirësojë shërbimin ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke mundësuar një proces më të strukturuar dhe efikas për qasjen në dokumentacionin arkivor, në përputhje me standardet më të larta institucionale dhe profesionale.



Gjatë nënshkimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Postën e Kosovës

- Në kuadër të marrëveshjeve ndërinstitucionale, është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dhe shkollës “Hoxhë Kadri Prishtina” në Fushë Kosovë. Ky memorandum ka për qëllim ofrimin e mundësive për zhvillimin e praktikës profesionale për nxënësit në ambientet e AShAK-së, duke u mundësuar atyre të fitojnë përvojë praktike dhe njohuri të thelluara mbi proceset arkivore, administrimin e dokumenteve dhe ruajtjen e trashëgimisë dokumentare.



Gjatë nënshkrimit dhe zbatimit të memorandumit të bashkëpunimit me shkollën “Hoxhë Kadri Prishtina” në Fushë Kosovë

11. KONFERENCA

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (AShAK) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë (DPA), më 9 qershor 2024, në qytetin e Elbasanit, u zhvilluan punimet e Konferencës VIII Mbarëkombëtare të Arkivistikës. Ky aktivitet tashmë është shndërruar në një traditë të rëndësishme shkencore, pas organizimit të suksesshëm të shtatë edicioneve të mëparshme në Tiranë, Prishtinë, Shkup, Sarandë, Tuz, Boletin dhe Manastir. Gjatë konferencës, arkivistë dhe studiues nga trevat shqiptare, përfshirë Kosovën, Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, prezantuan kumtesa dhe studime të rëndësishme mbi çështje arkivore, duke kontribuar në avancimin e kërkimeve dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e arkivistikës.



Gjatë Konferenca e VIII Mbarëkombëtare të Arkivistikës

12. PROMOVIME

12.1 Java e Arkivit të Hapur

Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 73-vjetorit të themelimit të Arkivit të Kosovës, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, nga data 18 deri më 22 mars 2024, organizoi aktivitetin tradicional **“Java e Arkivit të Hapur”**. Ky event kishte për qëllim sensibilizimin e opinionit të gjerë mbi rëndësinë e arkivave dhe promovimin e pasurisë dokumentare që administron ASHAK.

Gjatë kësaj jave, institucionin e vizituan rreth **900 vizitorë**, kryesisht nxënës dhe studentë, të cilët patën mundësinë të njihen nga afër me proceset arkivore dhe rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë dokumentare.



Java e arkivit të hapur

12.2 Promovimi i Revistës "Arkivat Shqiptare" dhe pjesëmarrja në Panairin e Tretë të Librit Akademik dhe Shkencor Mbarëkombëtar

Në datat 23-25 prill 2024, në kuadër të Panairit të Tretë të Librit Akademik dhe Shkencor Mbarëkombëtar, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, u zhvillua ceremonia zyrtare e promovimit të Revistës "Arkivat Shqiptare" nr.1-2, 59 - 2023. Ky botim përfaqëson revistën e përbashkët të dy institucioneve më të larta arkivore në hapësirën mbarëkombëtare, duke shërbyer si një platformë shkencore për studime arkivore.

Panairi, i cili këtë vit u mbajt në Tiranë, mbledhi studiues, akademikë dhe profesionistë të fushës, duke krijuar një hapësirë të rëndësishme për promovimin e veprave akademike dhe shkëmbimin e njohurive. Gjatë tre ditëve të pjesëmarrjes në këtë panair, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (ASHAK) prezantoi 31 tituj të botimeve, duke ofruar një pasqyrë të rëndësishme të kontributit të saj në fushën e arkivistikës dhe studimeve historike.



Gjatë promovimit të Revistes „Arkivat Shqiptare”, 1-2, 59-2023

12.3 Promovimi i Revistës "Arkivat Shqiptare" 1-2, 60-2024

Më 19 nëntor 2024, në Tiranë u promovua numri i ri i Revistës "Arkivat Shqiptare" nr. 1-2, 60-2024, botim i përbashkët i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë. Ky edicion i ri vazhdon të sjellë studime të rëndësishme arkivore, duke kontribuar në pasurimin e literaturës shkencore në fushën e arkivistikës.



Gjatë promovimit të Revistes „Arkivat Shqiptare”, 1-2, 60-2024

12.4 Promovimi i librit “Programi dhe Statuti i Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve”

Më 25 nëntor 2024, në ambientet e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës në Prishtinë, u promovua libri “Programi dhe Statuti i Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve” i Adem Demaçi, nga autori Selatin Novosella. Ky botim përfaqëson një dokument historik me vlerë të veçantë për të kuptuar angazhimin dhe përpjekjet e Lëvizjes Revolucionare për çështjen kombëtare shqiptare.



Promovimi i librit “Programi dhe Statuti i Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve”


13. EKSPOZITAT

13.1 Ekspozita për nder të 16-Vjetorit të Pavarësisë së Kosovës

Më 16 shkurt 2024, në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 16-Vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës hapi ekspozitën “VDES KUR DUA VETË”, kushtuar jetës dhe veprës së Adem Demaçit, një prej figurave më të shquara të rezistencës kombëtare.

E bazuar në materiale arkivore, ekspozita ofron një pasqyrim të rrallë mbi kontributin e Demaçit në letërsi dhe veprimtarinë e tij atdhetare, duke përfshirë dorëshkrime, dokumente hetimore dhe dosje penale. Në hapje, Drejtori Ekzekutiv i AShAK, z. Bislim Bislimi, dhe bashkëveprimtari Selatin Novosella theksuan rëndësinë e këtij eventi në njohjen dhe vlerësimin e trashëgimisë së tij në historinë kombëtare.

E vendosur në ambientet e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, ekspozita tërhoqi vëmendjen e studiuesve, institucioneve akademike dhe publikut të gjerë, duke shërbyer si një hapësirë reflektimi mbi qëndresën dhe sakrificën për lirinë e Kosovës



Pamje nga ekspozita „Vdes kur dua vetë”

13.2 Ekspozita “Rizgjimi në Vlerat Kombëtare, Kosova Republikë”

Më 12 qershor 2024, në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 25-Vjetorit të Çlirimit të Kosovës, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë, hapen ekspozitën “Rizgjimi në Vlerat Kombëtare, Kosova Republikë”. Ekspozita u hap në ambientet e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës në Prishtinë, duke sjellë dokumente dhe materiale arkivore të rëndësishme që pasqyrojnë rrugëtimin historik të Kosovës drejt lirisë dhe pavarësisë.

Në hapje, Drejtori i AShAK, z. Bislim Bislimi, theksoi rëndësinë e ndërgjegjes kombëtare dhe ruajtjes së kujtesës historike përmes dokumenteve arkivore, duke e cilësuar ekspozitën si një dëshmi të fuqishme të përpjekjeve për liri dhe shtetformim. Nga ana tjetër, përfaqësuesi i DPA, z. Lorenc Agalliu, vlerësoi materialet e ekspozuara si një pasqyrim të thelluar mbi historinë dhe rezistencën e popullit të Kosovës.

Ekspozita prezantoi dokumente dhe analiza nga vitet 1980-1981, duke ndriçuar momentet kyçe të lëvizjeve për liri dhe proceset që çuan në shpalljen e pavarësisë. E hapur për tre ditë, ajo ofroi një mundësi të çmuar për studiuesit dhe publikun e gjerë që të njihen nga afër me këto dëshmi historike



Pamje nga ekspozita “Rizgjimi në Vlerat Kombëtare, Kosova Republikë”

13.3 Ekspozita “Dorëshkrimet e Ismail Kadarese” në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës

Në kuadër të manifestimit shkencor Ditët e Alfabetit, më 23 nëntor 2024, në ambientet e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës në Prishtinë, u hap ekspozita “Dorëshkrimet e Ismail Kadarese”, e organizuar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë dhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup.

Ekspozita ofroi një pasqyrë unike të dorëshkrimeve të shkrimtarit të shquar Ismail Kadare, duke prezantuar fragmente dhe dokumente të rralla nga krijimtaria e tij. Ajo synoi të promovojë trashëgiminë letrare dhe arkivore, duke ndriçuar procesin krijues dhe vlerat artistike të një prej personaliteteve më të rëndësishme të kulturës shqiptare.



Pamje nga ekspozita “Dorëshkrimet e Ismail Kadarese”

13.4 Ekspozita “Të ndarë, por të pashkëputur”

Më 21 - 29 nëntor 2024, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjegjshme të Arkivave të Shqipërisë dhe shkollën European School of Kosovo në Mitrovicë, hapen ekspozitën “Të ndarë, por të pashkëputur”.

Ekspozitë, u hap në ambientet e shkollës „European School of Kosovo” në kuadër të për Ditën e Flamurit dhe shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Ekspozita pasqyrojë lidhjet e pandërprera historike dhe kulturore të shqiptarëve përtej kufijve, duke ofruar një qasje arkivore mbi dokumentet dhe dëshmitë e ruajtura ndër vite.



Pamje nga ekspozita “Të ndarë, por të pashkëputur” në ambientet e shkollës “European School of Kosovo”

14. UNIFIKIMI I PROCEDURAVE TË PUNËS

Në kuadër të përpjekjeve për standardizimin dhe përmirësimin e procesit të planifikimit, raportimit dhe unifikimit të procedurave dhe formularëve në AShAK, më 29.03.2024 u organizua një punëtori me pjesëmarrjen e Drejtorëve dhe Udhëheqësve të Divizioneve të institucionit.

Gjatë kësaj punëtorie u shqyrtuan dhe analizuan format e planifikimit të punës, formularët e kërkesave dhe dokumentet e tjera administrative të zbatuara nga AShAK dhe ANK-të. Si rezultat, u vendos të implementohet një qasje e unifikuar, duke përdorur të njëjtat formularë në të gjitha njësitë për të rritur koherencën dhe efikasitetin në menaxhimin e dokumentacionit dhe proceseve operative.

Gjithashtu, u miratua botimi i Regjistrave të Evidencës së Materialit Arkivor, të cilët do të shërbejnë për dokumentimin dhe monitorimin e materialeve që dalin nga depot e AShAK-së dhe ANK-ve për qëllime operative, duke përfshirë rregullimin dhe përpunimin arkivor, konservimin dhe restaurimin, si dhe procesin e digjitalizimit. Ky hap synonte të rrisë transparencën, gjurmueshmërinë dhe administrimin e materialeve arkivore në përputhje me standardet më të larta profesionale.

Në zbatim të këtij vendimi, janë hartuar dhe botuar 10 Evidenca për Materialin Arkivor, të cilat rregullojnë daljen e materialeve nga depot për punë operative. Paralelisht, janë përmirësuar dhe plotësuar Formularët Unik të Punës, të cilët tashmë janë shpërndarë për zbatim në të gjitha njësitë e AShAK-së, duke garantuar një administrim më efikas dhe të standardizuar të dokumentacionit.



Evidenca për Materialin Arkivor

15. TRAJNIME

15.1 Trajnimet profesionale

Nga data 26 deri më 28 maj 2024, u mbajt trajnim profesional për zyrtarët e AShAK-së në Shqipëri. Gjatë këtij trajnimi, u prezantua metodologjia e rregullimit dhe përpunimit të materialit arkivor, duke trajtuar sfidat e identifikuar gjatë procesit të punës dhe adresimin e tyre përmes zgjidhjeve të harmonizuara. Po ashtu, u diskutuan standardet e ruajtjes dhe procedurat e shfrytëzimit të materialit arkivor, me fokus në përmirësimin e menaxhimit dhe qasjes ndaj tij.

15.2 Trajnime të avancuara

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe përmirësimit të efikasitetit institucional, zyrtarët e AShAK-së kanë ndjekur një sërë trajnimesh të specializuara në fusha të ndryshme.

Më 29 maj 2024, dy zyrtarë morën pjesë në trajnimin mbi Raportimin për Planin e Integritetit në APK, organizuar në bashkëpunim me OSBE. Ky trajnim synoi të thellojë njohuritë mbi mekanizmat e raportimit dhe zbatimin e politikave të integritetit në institucionet publike.

-Në datat 30-31 maj 2024, dy zyrtarë ndoqën trajnimin mbi përdorimin e Microsoft Visio & Microsoft Publisher, të organizuar nga IKAP. Ky trajnim kishte për qëllim aftësimin në përdorimin e mjeteve vizuale dhe grafike për dokumentacionin institucional, si dhe përmirësimin e aftësive teknike në krijimin dhe administrimin e materialeve vizuale dhe informuese.

-Më 13-14 qershor 2024, tre zyrtarë morën pjesë në trajnimin mbi Zhvillimin e Politikave Publike Efektive, organizuar nga IKAP.

Ky trajnim u fokusua në analizën dhe formulimin e politikave publike, me qëllim përmirësimin e kapacitetit të institucionit në hartimin dhe zbatimin e strategjive zhvillimore.

-Dy zyrtar të AShAK janë trajnuar e Certifikuar për Prokurim publik, në IKAP.

-Dy zyrtarë janë trajnuar dhe Certifikuar në fushën e financave, përkatësisht në E –pasuri.

Pjesëmarrja në këto trajnime synon forcimin e kapaciteteve institucionale të AShAK-së, duke avancuar kompetencat profesionale të zyrtarëve në administrimin arkivor, raportimin institucional dhe përdorimin e programeve IT për përmirësimin e proceseve të punës.

16. INVESTIMET KAPITALE

16.1. Renovimi i objektit të AShAK

Në vitin 2024 u realizua projekti i renovimit të AShAK (faza e parë), duke shënuar një hap të rëndësishëm në modernizimin dhe ruajtjen e institucionit. Me këtë renovim u siguroa hapësirë funksionale, e sigurt dhe efikase për arritjen e objektivave. Ky investim kontribuoi në ruajtjen e trashëgimisë kombëtare dhe ofron kushte më të mira pune për zyrtarët, si dhe për studiuesit, historianët e publikun. Institucioni mbetet i përkushtuar për të garantuar cilësinë e punimeve në vijim, duke siguruar një mjedis bashkëkohor për arkivat kombëtare.



Gjate procesit të renovimit



Pas përfundimit të renovimit



Renovimi i ndërtesës së ASHAK


16.2 Hartimi i Projektit për ndërtimin e Arkivit Ndërkomunal në Gjilan

Në kuadër të përpjekjeve për modernizimin dhe zgjerimin e kapaciteteve arkivore në Kosovë, është përmbyllur me sukses procedura e tenderimit dhe është nënshkruar kontrata për hartimin e projektit ideor dhe kryesor të ndërtesës së Arkivit Ndërkomunal në Gjilan. Ky projekt përfaqëson një hap të rëndësishëm në përmirësimin e infrastrukturës institucionale për ruajtjen, administrimin dhe promovimin e dokumentacionit historik dhe kulturor me rëndësi kombëtare. Me finalizimin e kësaj kontrate, tashmë është vendosur baza për nisjen e punimeve në ndërtimin e Arkivit Ndërkomunal në Gjilan, i cili do të shtrihet në një hapësirë prej rreth 4,100 m².

Ky objekt do të përmbushë të gjitha standardet bashkëkohore për ruajtjen dhe administrimin e materialit arkivor, duke përfshirë:

- Depo të reja dhe moderne për ruajtjen e materialeve arkivore me kushte të avancuara klimatike dhe sigurie;
- Salla muzeale dhe hapësira ekspozuese për prezantimin e trashëgimisë dokumentare;
- Salla të prezantimit dhe hulumtimit, të destinuara për studiuesit dhe akademikët që angazhohen në kërkim shkencor;
- Bibliotekë arkivore, e cila do të ofrojë literaturë të pasur në fushën e arkivistikës dhe historisë;
- Zyra dhe hapësira pune për administratën dhe shërbimet profesionale të institucionit.

Ky investim strategjik do të përmirësojë ndjeshëm kapacitetet për menaxhimin e dokumenteve me vlerë historike, duke ofruar kushte të përshtatshme për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë arkivore në nivel kombëtar.



Projekti për ndërtimin e Arkivit Ndërkomunal në Gjiilan

16.3 Funkcionalizimi i Kazermës së Vjetër në Prizren për Arkivin Ndërkomunal të Prizrenit

Procesi i restaurimit dhe adaptimit të Kazermës së Vjetër në Prizren ka vijuar sipas dinamikës së paraparë në kontratë, duke u zhvilluar në përputhje me standardet më të larta të konservimit dhe restaurimit të objekteve me vlerë historike dhe kulturore. Ky projekt përfaqëson një hap të rëndësishëm në ruajtjen e trashëgimisë arkitektonike dhe transformimin e kësaj ndërtese historike në një institucion funksional për Arkivin Ndërkomunal të Prizrenit. Me përfundimin e punimeve, Kazermës së Vjetër do t'i kthehet funksionaliteti përmes adaptimit të saj në një qendër të rëndësishme arkivore, e cila do të shërbejë për grumbullimin, ruajtjen dhe promovimin e dokumentacionit me rëndësi historike për rajonin e Prizrenit. Ky projekt jo vetëm që do të forcojë infrastrukturën arkivore në Kosovë, por gjithashtu do të ndihmojë në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të qytetit të Prizrenit si një qendër me vlera të veçanta historike.



Kazerma e vjetër në Prizren, gjatë restaurimit dhe përgatitjes për ANK –Prizren

16.4 Renovimi i Arkivit Ndërkomunal të Mitrovicës

Në kuadër të përmirësimit të kapaciteteve për ruajtjen e materialit arkivor, filluan punimet për renovimin dhe adaptimin e hapësirës shtesë të dedikuar për ruajtjen e materialeve arkivore në Arkivin Ndërkomunal të Mitrovicës. Kjo hapësirë, e cila është vënë në dispozicion nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës, do të shërbejë si një ambient i posaçëm për depozitimin dhe menaxhimin e materialeve me vlerë historike, duke kontribuar në ruajtjen e trashëgimisë dokumentare të rajonit.

Ky projekt është ndërmarr me qëllim të krijimit të një mjedisi të sigurt dhe funksional, i cili përmbush standardet ndërkombëtare për ruajtjen afatgjatë të materialit arkivor.




Objekti para procesit të renovimit



Objekti gjatë procesit të renovimit

16.5 Renovimi i Depos në Arkivin Ndërkomunal të Pejës

Pas përfundimit me sukses të procedurave të prokurimit, ka filluar zbatimi i procesit të renovimit të depos (podrumit) në Arkivin Ndërkomunal të Pejës. Ky projekt ka për qëllim përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese, duke krijuar kushte optimale për ruajtjen dhe menaxhimin afatgjatë të materialeve arkivore në përputhje me standardet bashkëkohore të arkivistikës. Ky proces do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e kapaciteteve arkivore në ANK Pejë, duke siguruar një mjedis të përmirësuar dhe të sigurt për ruajtjen e trashëgimisë dokumentare.



Procesi i renovimit të depos në ANK Pejë

16.6 Funkcionalizimi i objektit të ri për Arkivin Ndërkomunal të Gjakovës

Në kuadër të përpjekjeve për përmirësimin e shërbimeve publike dhe garantimin e ruajtjes së materialit arkivor, Gjykata Themelore në Gjakovë ka vënë në shfrytëzim afatgjatë një objekt të dedikuar për Arkivin Ndërkomunal të Gjakovës. Kjo nismë përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt forcimit të infrastrukturës institucionale, duke siguruar një mjedis të përshtatshëm për menaxhimin dhe administrimin e materialeve arkivore me standardet më të larta profesionale.

Në kuadër të këtij procesi, janë zhvilluar procedurat e prokurimit për renovimin dhe përshtatjen funksionale të hapësirave të reja, të cilat do të mundësojnë krijimin e kushteve optimale për ruajtjen, hulumtimin dhe qasjes në dokumentacionin arkivor.

Këto projekte janë mbështetur dhe financuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duke reflektuar përkushtimin institucional për zhvillimin e kapaciteteve arkivore dhe ruajtjen e trashëgimisë dokumentare.



Procesi i përgatitjes së objektit të ri në ANK Gjakovë

17. BUXHETI DHE FINANCAT

Bazuar në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, buxheti fillestar i alokuar për Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, për vitin fiskal 2024 ishte 1,571,274.00 euro. Nga ky buxhet është planifikuar mbështetje për realizimin e objektivave të institucionit, duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës arkivore, digjitalizimin e materialeve arkivore dhe rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike.

Raporti për buxhetin e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës për vitin 2024 përfshinë detaje mbi:

- Buxhetin fillestar të planifikuar;
- Lëvizjet buxhetore, duke përfshirë transferimet, rialokimet dhe lirimet e mjeteve sipas kërkesave specifike;
- Të hyrat vetanake të gjeneruara gjatë periudhës raportuese;
- Shpenzimet totale, të pasqyruara edhe në përqindje për të ilustruar shkallën e realizimit të buxhetit.

Kjo përmbledhje ofron një pasqyrë të qartë dhe transparente të menaxhimit financiar të institucionit gjatë vitit në fjalë.

Nr.	Kategoria Ekonomike	Fondi	Buxheti Fillestar (€)	Transferet (€)	Buxheti Përfundimtar (€)	Shpenzimet (€)	Realizimi (%)
1	Pagat & Mëditjet	10	813,689.00	/	754,182.21	754,182.21	92.69
2	Mallrat & Shërbimet	10	118,910.00	90,000	208,910.00	195,291.75	93.67
3	Mallrat & Shërbimet	21	31,090.00	/	31,090.00	6,195.88	20.00
4	Mallrat & Shërbimet	22	/	6,587.80	6,587.80	6,578.22	99.85
5	Komunalet	10	27,585.00	-	27,585.00	13,965.06	50.63
6	Kapitalet	10	580,000.00	-70,721.00	509,279.00	479,663.44	94.18
Totali i Buxhetit			1,571,274.00		1,537,634.01	1,455,876.56	92.66

18. BURIMET NJERËZORE

Gjatë vitit 2024, Divizioni për Burime Njerëzore ka realizuar gjithsej trembëdhjetë (13) procedura të pranimit në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.

Në vijim paraqiten detaje për realizimin e rekrutimeve:

1. Receptonist në AShAK (RN00011862) – një (1) njësi;
2. Zyrtar i Lartë i Mbikëqyrjes, Administrimit dhe Mbështetjes së Punës Huluntuese në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (RN00012936) – një (1) njësi;
3. Restaurator në Divizionin për Mbrojtjen e Lëndës Arkivore (RN00013869) – një (1) njësi;
4. Zyrtar i Lartë për Promovim të Veprimtarisë Huluntuese Arkivore në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (RN00014092) – një (1) njësi;
5. Zyrtar i Lartë për Financa (RN00014060) – një (1) njësi;
6. Zyrtar i Arkivit – Arkivist 2 (RN00013453) – katër (4) njësi;
7. Zyrtar për Arkiv 2 – DVA (RN00014165) – një (1) njësi;
8. Zyrtar për Arkiv 2 – ANK – Prishtinë (RN00014172) – një (1) njësi;
9. Zyrtar për Arkiv 2 – ANK – Gjakovë (RN00014174) – një (1) njësi;
10. Zyrtar i Logjistikës në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (RN00014070) – një (1) njësi;
11. Zyrtar për Arkiv 2 – ANK Ferizajt (RN00015327) – një (1) njësi;
12. Udhëheqës i Divizionit të Arkivit Ndërkomunal të Pejës në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (RN00013777) – një (1) njësi;
13. Udhëheqës i Divizionit të Arkivit Ndërkomunal të Gjakovës (RN00015320) – një (1) njësi.

Procedurat e kontraktimit për marrëdhënie pune me kontratë të caktuar

Në bazë të Rregullores (QRK) Nr. 03/2024 për themelimin e marrëdhënies së punës me kontratë për periudhë të caktuar, janë realizuar katër (4) procedura kontraktimi si më poshtë:

1. Zyrtar për Arkiv – ANK - Pejë (RN00015628) – një (1) njësi;
2. Zyrtar për Arkiv – ANK - Mitrovicë (RN00015624) – dy (2) njësi;
3. Zyrtar për Arkiv 2 – ANK - Prishtinë (RN00015627) – dy (2) njësi;
4. Zyrtar për Arkiv 2 – Divizioni i Rregullimit dhe Përpunimit të Lëndës Arkivore për projektin e digjitalizimit të materialit arkivor (RN00015815) – dy (2) njësi.

Përveç zhvillimit të procedurave të pranimit sipas Rregullores për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil dhe atyre të kontraktimit, Divizioni për Burime Njerëzore (DBNJ) ka realizuar edhe detyra të tjera profesionale dhe procedurale, të cilat përfshijnë:

Në përputhje me strukturën e re të AShAK, janë hartuar përshtatjet e detyrave të punës për secilën pozitë. Ky proces përfshin rishikimin dhe përshtatjen e strukturës organizative të AShAK, në bazë të Rregullores Nr. 16/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, me synim përmirësimin e funksionalitetit dhe rritjen e efikasitetit institucional.

- Rishikimi dhe përshtatja e nivelit të pagave sipas pozitave, kompetencave dhe përgjegjësi të përcaktuara në organogramin e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dhe vendimeve të Drejtorit Ekzekutiv.
- Dokumentimi dhe verifikimi i përvojës së punës për secilin zyrtarë, për të siguruar një sistem të saktë dhe të drejtë pagash që reflekton përvojën profesionale dhe kontributin e secilit.
- Ndërmjetësimi dhe koordinimi me IKAP për sigurimin e trajnimeve të akredituara dhe cilësore në fushat e rëndësishme profesionale të legjislacionit të shërbimit civil.

Këto arritje reflektojnë përkushtimin e DBNJ për të përmbushur detyrat e tij në përputhje me standardet e administratës publike dhe për të mbështetur qëllimet strategjike të AShAK.

19. PROKURIMI

Pas miratimit të buxhetit, për vitin fiskal 2024, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës ka përgatitur dhe dorëzuar Planifikimin Final të Prokurimit në Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP). Ky proces është realizuar në përputhje me kërkesat e njëjësive kërkuese (departamenteve) dhe aprovuar nga Kryeshafi Ekzekutiv.

Bazuar në Planin e Prokurimit, gjatë vitit janë realizuar procedura të ndryshme të prokurimit, duke siguruar përmbushjen e nevojave institucionale dhe përdorimin e drejtë të fondeve publike. Për çdo aktivitet të realizuar, janë gjeneruar urdhërblertje përkatëse nga Sistemi i Menaxhimit të Financave Publike të Kosovës (SMFPK). Këto urdhërblertje janë përdorur për të mbuluar shpenzimet e prokurimit, bazuar në kontratat e nënshkruara me operatorët ekonomikë.

Në përfundim të vitit, është përgatit Raporti i Prokurimeve për vitin fiskal 2024 dhe është hartuar Plani i Prokurimit Publik për vitin 2025, i cili është dorëzuar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit Publik, duke përmbushur të gjitha kërkesat ligjore dhe procedurale.

Ky proces reflekton përkushtimin e AShAK-së për të siguruar transparencë, efikasitet dhe përgjegjshmëri në menaxhimin e fondeve publike.

Në vazhdim paraqesim aktivitetet e prokurimit publik, të realizuara gjatë vitit 2024 në AShAK.

Në vazhdim paraqesim aktivitetet e prokurimit publik, të realizuara gjatë vitit 2024 në AShAK:

Nr.	Përshkrimi i kontratës
1.	Digjitalizimi i Materialit Arkivor
2.	Punët rinovuese të ndërtesës qendrore dhe oborrit të AShAK-ut
3.	Furnizimi me pajisje të TI-Skaner për skenimin të materialit arkivor në ANK Gjakovë
4.	Shërbime të transportit me autobus për AShAK
5.	Furnizimi dhe montimi i klimës në AShAK
6.	Shtypja e librit Programi dhe Statuti i Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve
7.	Furnizimi dhe montimi i klimave në salla të AShAK-ut
8.	Furnizimi me skaner për digjitalizimin e materialit arkivor në ANK Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Ferizaj dhe Gjiilan
9.	Furnizim me kasetë me shirit për barkodinimin e asetëve.
10.	Servisim i veturës zyrtare të AShAK-së
11.	Sigurimi i automjetit të ri të AShAK-ut
12.	Konkursi i projektimit për projektin ideor dhe kryesor të ndërtesës së arkivit në ANK Gjiilan.
13.	Rregullimi i derës mbrojtëse të Depos dhe perdeve në Arkivin Ndërkomunal Ferizaj
14.	Furnizim me kuti arkivore
15.	Furnizim me inventar specifik për Sallën e hulumtimeve
16.	Punët shtese në kontratën 12500-24-2378-5-2-1 C61 Punët rinovuese të ndërtesës qendrore dhe oborrit të AShAK-ut
17.	Furnizim me tabela informuese për Drejtoret e Departamenteve të ASHK-ut

Nr.	Procedura të realizuara që janë në proces
1.	Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Materialeve Arkivore-ASHAK
2.	Furnizim me mjete mbrojtëse dhe me material zyrtar